



Prishtine, 23.06.2020

Ref. 008/2020

Në bazë të nenit 63 para 3 të Ligjit Nr.03/L-163 për Miniera dhe Minerale, nenit 23 dhe nenit 39 para 3 të Ligjit Nr.04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.3/L-163 për Miniera dhe Minerale, si dhe në pajtim me pikën 4 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.02/06 dt. 17.06.2020, Drejtori i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale nxjerr këtë:



VENDIM PËR MASAT MBROJTËSE NDAJ PANDEMISË COVID-19

1. Obligohet i gjithë stafi i KPMM-së të respektoj rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë për masat mbrojtëse nga Covid-19.
2. Obligohen stafi i KPMM-së që gjatë kryerjes së detyrave të punës të përdorin maska, doreza, dhe të ruajnë distancë.
3. Obligohen Kryesuesit e Departamenteve që të bëjnë organizimin e stafit në pajtim me Vendimin e Qeverisë, duke përfshirë këtu organizimin e punës në distancë fizike nga shtëpitë e tyre apo online dhe me staf të reduktuar.
4. Në pajtim me pikën 3 të këtij vendimi, obligohen të gjitha departamentet e KPMM-së që për çdo zyrë të caktojnë nga një zyrtar kujdestar që do të jetë prezent në zyrë nga ora 08:00 deri në orën 16:00
 - 4.1. Në pajtim me pikën 4, obligohen të gjithë Kryesuesit e Departamenteve të dorëzojnë një orar ku me rrotacion do të caktohen zyrtaret kujdestar , në bazë të parimit të ndarjes së barabartë të kohës dhe detyrave.
5. Në raste të angazhimit të stafit të terrenit dhe seancave për përfaqësuesit ligjor të KPMM-së, në raste kur ka angazhime jashtë objektit të KPMM-së, organizimi i punës bëhet sipas kërkesave të Kryesuesve të Departamenteve. Obligohen i gjithë stafi që pavarësisht pikës 4 të këtij vendimi që kur kërkohet nga Kryesuesit e Departamenteve të kryejnë obligimet dhe detyrat e punës.
6. Obligohen Kryesuesit e Departamenteve të sigurojnë zbatimin e këtij vendimi dhe në pajtim me këto masa të organizojnë punën e stafit dhe në mënyrë që të realizohen të gjitha detyrat e punës së KPMM-së.

6.1. Në raste kur Kryesuesit e Departamenteve nuk janë në punë obligohen që organizimin ta bëjnë me email/online dhe të caktojnë zyrtarin/en që i zëvendëson.

Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.



Ramiz Krashiqi
Drejtori
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

Vendimi t`i dërgohet:
Të gjithë stafit të KPMM-së;
Arkives së KPMM-së;